REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2018:038707
Datë: 16.07.2019
Numri i dokumentit: 00449500

P.nr.127/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Divizioni penal, me gjyqtarin Lulzim Paçarizi, si dhe zyrtaren administrative Hatixhe Begaj, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. B., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 parg.6 lidhur me parg.1 të KPRK-së (Kodit nr.06/L-074), ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.411/2018 të dt. 15.03.2018, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, ku prezent ishin Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, dhe i akuzuari M. B. me dt. 16.07.2019, shpallë këtë, ndërsa me dt.05.08.2019 përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: M. B., nga i ati H. dhe e ëma A. e lindjes K., i lindur më datën …, në fshatin B., komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me nr. personal …, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, i ati i … fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, pensioner, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Për shkak se nga data e pa vërtetuar e gjerë më datën 27.09.2017, në shtëpinë e tij në fshatin B., Komuna e Malishevës me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 parg.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Kosovës, në atë mënyrë që pa njehsorë elektrik është lidhur direkt në rrjetin elektrik, kështu ka penguar regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar, me ç'rast të dëmtuarës K. – Divizioni në G., i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 181.38 euro.

-me këtë ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 parg.6 lidhur me parg.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodit nr.06/L-074).

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40, 46, 47, 48, 49 dhe nenit 69 të KPRK-së si dhe nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovë të njëjtit ia shqipton:

DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që të akuzuarin e gjykon me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **4 (katër)** muajve, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara K. - Distrikti në Gj., lidhur me kërkesën pasurore juridike udhëzohet në kontestin e rregullt civil.

2018:038708

Obligohet i akuzuari në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t`ia paguajë shumën prej 30 euro ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të behet me detyrim.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.411/2018 e ka akuzuar të akuzuarin në fjalë, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Prokurori i shtetit me rastin e leximit të aktakuzës, në kuptim të nenit 2 dhe 3 të KPRK-së, i cili tani është në fuqi, bënë rikualifikimin e veprës penale nga neni 320 të ish KPRK-së, në nenin 314 parg.6 lidhur me parg.1 të KPRK-së (Kodit të Ri), duke marrë parasysh se me ish Kodin Penal për këtë vepër penale janë paraparë dënimet komulative me gjobë dhe me burg deri në tre (3) vjet, ndërsa me Kodin e tanishëm Penal është paraparë dënimi alternativ me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, çka nënkupton se Kodi i Ri Penal është më i favorshëm për të akuzuarin, duke marrë për bazë nenin 3 të këtij Kodi sikurse u cek më lartë.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 16.07.2019, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, si dhe i akuzuari, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I pandehuri në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, më vjen keq për rastin i cili ka ndodhur, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, andaj kërkojë nga gjykata që me rastin e shqiptimit të dënimit t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe të më shqiptojë një dënim sa më të butë, i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që mos të kryej kurrfarë vepre penale.

Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe meqenëse i akuzuari e pranoj fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata t'i ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lart, ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke e vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në caktimin e llojit

2018:038708

dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, pendimin e tij, mbajtës i familjes prej 12 anëtarësh, asnjëri i punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, pensioner, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, sjellja e tij në shqyrtim, si dhe nuk është përsëritës i veprave penale, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht (dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 4 muajve), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit prej një 1 viti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 të KPRK-së, dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil gjykata e mbështeti ne nenin 463 par.1 dhe.2 të KPPK-së, ndërsa vendimin mbi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale gjykata e mbështeti në nenin 450 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
P.nr.127/18, me dt.16.07.2019.

Zyrtare administrative
Hatixhe Begaj

G j y q t a r i
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.

2018:038708